

EVALDA PACI

LETËRSIA E VJETËR SHQIPE NË DRITËN E VËZHGIMEVE HISTORIOGRAFIKE. KONTRIBUTE DHE QASJE STUDIMORE

Letërsia e vjetër shqipe përfaqëson një prej periudhave më me interes në pikëpamje të studimeve që orientohen ndaj vetë harkut kohor dhe tipareve të tjera që e karakterizojnë, duke mbetur dhe një prej argumenteve që kohët e fundit ka tërhequr vëmendjen e gjurmuesve të dokumentacionit arkivor që e përfshin atë. Periudha që ka të bëjë me shekujt në të cilët kjo traditë shkrimore dhe letrare u përvijua në tipare dhe përmbajtje shënohet dhe nga ngjarje që në një mënyrë ose tjetër lidhen me çështje të kulturës së shkrimit dhe të përhapjes së librave të shtypur në Evropë dhe Ballkan. Mbetet përherë e më me interes në këndvështrimin tonë parashtrimi i një kuadri ndërkulturor që sheh të përfshirë në mënyrë të pandashme zhvillime të kulturës së shkrimit në vise të caktuara të arealeve të sipërcituara, për të parë më tej në një mënyrë më të përqendruar dhe çka burimet përkatëse dhe studimet mbi to ofrojnë në lidhje me viset arbërore dhe ngjarjet gjegjëse.

Vëmendja ndaj autorëve të veprave të letërsisë së vjetër shqipe është shfaqur gradualisht në kohë dhe një fakt i tillë dëshmohet në korpuse të plota dokumentare që falë natyrës së mirëfilltë kronografike, analitike dhe evidentuese, ofrojnë mundësinë për të ndjekur dhe vështrimet që nuk munguan të përpiloheshin mbi prelatët që nën petkun e misionarit u lidhën ngushtë me viset tona dhe konkretizuan me libra përkatës përkushtimin e rrallë ndaj çështjes së atdhetarisë dhe lëvrimit të gjuhës.

Provë e kësaj lidhjeje janë të gjitha dëshmitë që bëhen shtysë që periudha kohore që zë fill kryesisht në Katërqindën për një pjesë mbizotëruese të studiuesve, të emërtohet letërsi e vjetër shqipe.¹ Natyra e teksteve, mjaft specifike nga përmbajtja dhe paracaktimi, përafron natyrshëm letërsinë ekleziastike në viset tona me tradita të ngjashme ekzistuese në lokalitetet e afërta në pikëpamje gjeografike, por dhe më tej, në gji të Evropës.²

¹ Një dëshmi fragmentare, por mjaft e rëndësishme për studimet albanologjike e mbi të gjitha ato të historisë së shkrimit shqip mbetet Formula e Pagëzimit, e datuar në vitin 1462.

² Një lidhje më se e qartë shihet se mund të krijohet duke pasur parasysh arritjet më të mira në këtë fushë që u mundësuan nga lindja dhe zhvillimi i mëtejshëm i shtypshkrimit,

Një traditë e tillë mori një përvijim paksa më të veçantë biografik me lindjen e shtypshkrimit dhe promovimin e praktikave e teknikave që sollën më afër librin si mjet për të transmetuar kulturën si nocion dhe tekstin bibliik si një mjet që ofronte njohje dhe pasurim dituror e shpirtëror për individin.

Shtypshkrimi si praktikë që do të përpunohej e përmirësohej nga viti në vit, nuk arriti ta zbehë menjëherë manuskriptin dhe përgatitjen e kodikëve me tekste të së njëjtës natyrë të sipërcituar, ndërkohë që ngulitja e pasqyrimit të indiceve konkrete në frontespice dhe kolofone shpinte qartësisht ndaj autorit dhe historikut të veprës së përgatitur prej tij. Një kulturë e tërë reflektohet në procesin aq interesant të konsolidimit të njohjes dhe rrugëtimit të një mjete të ri për format mendore të kohës, pikërisht librit të shtypur, si një potencial në duart e tipografëve dhe shtypshkruesve të saj.³

Shqyrtimi i elementeve biografike të autorëve të kësaj letërsie përbën prej kohësh një çështje që ofron shtypsa edhe për kërkime të posaçme arkivore, të përqendruara në hollësi që ndriçojnë problematika më madhore se detajet individuale. Në anale e korpuse që vijojnë të jenë burime dokumentare përherë të konsultueshme, sqarohet dhe ecuria e emërimeve që në të vërtetë përbën një mënyrë për të gjurmuar periudhat në të cilat bëhet i njohur emri a veprimtaria e prelatëve që janë dhe autorët e letërsisë së vjetër shqipe.⁴

që përfshiu pa dyshim dhe libra me destinacion praktik kishtar, gjithashtu dhe vepra më të thelluara, gjithnjë të prirur nga e njëjta tematikë.

³ Shtypshkrimi si praktikë i njihen mjaft avantazhe, ndër të cilat alfabetizimi i popullsisë të vendeve që e aplikuan dhe të tjera përparësi kryesisht të natyrës ekonomike ndaj përdorimit të librave të realizuar me metoda të tjera. Shtypshkrimi u përrua me vepra të ndryshme, ndër të cilët mund të citojmë traktate të nocioneve gramatikore, por dhe variante të Biblës, që dhe sot e kësaj dite paraqesin veçanti teknografike dhe përmbajtësore. Përrurimi i shtypit të librave është konsideruar një inovacion me rëndësi të veçantë, duke qenë se dhe komunikimi mes njerëzve u orientua drejt mjetesh të reja ndërkëmbimi. Realizimi i librit të shtypur ndërkohë u shoqërua dhe nga përrllogaritje të reja që merrnin parasysh dhe qarkullimin e varianteve librore të botuara apo të ngjashme, fakt që mund të kushtëzonte dhe ekonomikisht realizimin e kësombllave të reja. Pa dyshim që me gjithë faktin që librat e parë që u shtypën apo dolën nga tipografitë nuk shfaqnin dallime të mëdha në krahasim me ata të shkruar me dorë, risitë që solli shtypshkrimi ishin rrënjësore për kulturën librore në Evropë.

⁴ Duke pasur parasysh korpuse të caktuara që përmbajnë të dhëna mbi prelatët që qenë misionarë në viset tona, do të citonim dhe materiale dokumentare në të cilat gjinden të ndërmendur Pjetër Budi, Pjetër Bogdani, Frang Bardhi, Gjon Nikollë Kazazi etj. Paragrafë tipikë kushtuar veprimtarisë misionare dhe detyrave të shërbesës që kanë kryer në dioqeza e ipeshkvi të caktuara përbëjnë dhe burime referimi në lidhje me këta të fundit, gjithnjë të vlefshme duke konsideruar dhe faktin që përrmes tyre dokumentohen dhe hollësi e fakte të tjera që kanë të bëjnë me regjistrimin në analet e kohës të emrave të përveçëm, toponimeve e antroponimeve.

Ekzemplarët që e përfaqësojnë këtë letërsi janë të një veçantie të spikatur, duke qenë e mundur dhe të gjinden e të parashtrihen në lidhje me secilën përkime përmbajtësore me modele që u përruruan në vise të afërta që ishin të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në çështjen e përrurimit të librit me tematikë liturgjike dhe teologjike. Çdonjëra nga veprat e letërsisë së vjetër shqipe ka historikun e vet në pikëpamje të pikënisjes dhe motivimit të përrpilit, por dhe rrethanave në të cilat shohin dritën e botimit. Pavarësisht paqartësive që lidhen me data dhe të dhëna konkrete që largësia kohore nuk i lehtëson përr studiuesit e këtyre veprave, përr disa prej tyre është e mundur të ilustron hollësi dhe elemente që mundësohen nga dokumentacioni arkivor përrkatës. Njohja më e thelluar e kësaj periudhe dhe uniformimi i informacioneve bazike që duhen disponuar në lidhje me autorë dhe vepra përrbën përrherë një pistë përr t'u ndjekur me këmbëngulje dhe me një metodologji më të përrcaktuar nga hulumtuesit e saj dhe të mbarë kontekstit që lidhet me të.

Metodologjia e studimit të periudhës që lidhet me lulëzimin e letërsisë së vjetër shqipe dhe prirjet përr të veçuar dimensione thellësisht gjuhësore që gjurmoheshin në tekstet gjegjëse të kësaj letërsie, janë çështje përr t'u konsideruar pjesë e gjithë panoramës studimore që përr hir të së vërtetës gëzon një historik të saj in mbas nënvizimeve të rëndësisë që paraqesin veprat gjegjëse nga prelatë të letrave shqipe, të nxitur përr të kërrkuar konkretisht e mbi bazë indicesh veçanërisht në fund të shekullit XIX e në dekadat e para të shekullit të kaluar. Kërrkimet dhe ndërrmendjet që risollën në vërrmendje të personaliteteve të kohës dhe çështjen e evidentimit të kërrsombllave përrkatëse të këtyre veprave janë gjithashtu dhe një linjë që zbulon përrfshirjen e prelatëve të arealit arbëresh në këtë problematikë, duke qenë drejtpërrdrejt të interesuar në pikëpamje të njohjes dhe rizbulimit të teksteve që kishin përrmbajtje dhe paracaktim të qartë liturgjik dhe kishtar.

Një argument më vete duhet të përrbëjë dhe konsiderimi i teksteve më të veçuara, të ndryshme nga veprat që i atribuojmë kësaj letërsie e që në pikëpamje kronologjike duhet t'u prijnë këtyre të fundit. Gërrshetimi i kompetencave që ndihmojnë ndjeshëm filologët dhe studiuesit e teksteve përr t'i kategorizuar këto të fundit, mbetet një domosdoshmëri që duhet rivlerësuar dhe në ditët e sotme, duke qenë fare e qartë që në saktësimin kronologjik dhe në përrcaktimin e përrkatësisë së këtyre teksteve në një traditë letrare e gjuhësore më vete ndërhyjnë pikërisht mjaft faktorë, ndër të cilët më të rëndësishmit mbeten ata historikë e që lidhen dhe me kontekstin që favorizoi lindjen e tyre.

Teksteve të emërrtuara si parabuzukiane Mario Roques (1875-1961) u kushton një paragraf të rëndësishëm në veprën e çmuar me titull *Recherches sur les anciens textes albanais* (Paris, 1932). Nuk janë të shumtë në numër, por secili përrbën një realitet më vete, qoftë dhe në pikëpamje të destinacionit që

duhet të ketë pasur që në gjenezën përkatëse. Gjithashtu, Roques tërheq vëmendjen mbi nevojën e njohjes së drejtpërdrejtë të veprave dhe dokumentimeve më të hershme të letërsisë së shkruar shqipe, në ekzemplarë botimesh dhe ribotimesh, fakt që në shekujt që i prinë botimit të punimit të tij mbi tekstet e vjetra shqipe paraqet paqartësi referimi në rastin e disa studuesve që u referohen periudhave më të hershme të historisë së shkrimit shqip.

Si çdo traditë shkrimore dhe letrare që kërkon kritere njohjeje dhe saktësi në dëshmi shkrimore dhe referenciale, dhe ajo e letërsisë së vjetër shqipe, për vetë shekujt në të cilët gjen konkretizimin e saj dhe ecurinë në vepra që pasojnë njëra-tjetrën paraqitet me interes të veçantë studimor, ndaj të cilit nuk ka munguar vëmendja dhe as prirja për ta trajtuar dhe analizuar në aspekte të përvijimit dhe profilit përkatës. Njohja konkrete ndaj veprave që e përfaqësojnë një letërsi të tillë ka kaluar në hapa që me kalimin e kohës u janë afruar më shumë burimeve më të hershme që njihen dhe sot e kësaj dite si më të parat dokumentime shkrimore në lidhje me gjuhën shqipe dhe letërsinë e saj të shkruar. Natyrisht, një përzgjedhje e domosdoshme ka bërë që të përafrohen për nga përmbajtja dhe dëshmitë fragmentare ndaj veprave më të plota të cilat dhe duke u paraqitur nën një autorësi konkrete, përbëjnë dhe ekzemplarët e mirëfilltë që e përbëjnë këtë të fundit në pikëpamje modelesh dhe komponimesh tekstore.

Duke pasur parasysh ç'shkollë studimore i përkiste Roques dhe cilat ambiente akademike vlerësonin kompetencën e tij në fushë të filologjisë romane, studimeve orientale dhe rolin që luante në qarqet akademike të kohës, mund të themi me plot gojën që interesimi i tij në pikëpamje të evidentimit të burimeve tekstore dhe bibliografike që dëshmonin praninë e kësombllave të veprave të letërsisë së vjetër shqipe në bibliotekat më të mira të kohës, i dha një shtysë vendimtare dhe rinënvizimit të interesit ndaj vlerave të dëshmimeve shkrimore më të hershme në gjuhën tonë, që përbënin referenca me rëndësi dhe për çështje të tjera si historia e librit të shtypur, kultura librare në viset tona dhe përkime të saj me prirje në rrethet evropiane. Veçanërisht në periudhën në të cilën veprimtaria kërkimore e Mario Roques u përqendrua dhe në nënvizimin e domosdoshmërisë së njohjes mbi kritere filologjike dhe shkencore të letërsisë së vjetër shqipe, të përkohshmet dhe revistat shkencore më serioze të kohës e bënë zë të vetin dhe një element të tillë, sigurisht duke vlerësuar objektivisht dhe vlerat që njohja e shqipes paraqiste për disiplina si gjuhësia historike dhe ajo e krahasuar.

Jemi të mendimit që njohja dhe konsiderimi i zhvillimeve që lidhen pikërisht me librin dhe në veçanti me librin e shtypur duhet konsideruar një faktor që ka ndikuar dhe në realizimin e ekzemplarëve që përfaqësojnë atë që unanimisht emërtojmë si *letërsi e vjetër shqipe*.

Përtej faktit që duhet rivlerësuar rëndësia e njohjes së kësombllave të tjera që mund të disponojnë arkiva dhe biblioteka, përtej domosdoshmërisë që

paraqet dhe analizimi i fondeve apo i indekseve që përmbajnë libra në momente të caktuara dhe të larguara nga vëmendja e konsultimit, shtypshkrimi si fakt kulturor që ndikoi dhe në leximin ndryshe të veprave në shekullin XVI e më tej, duhet parë si një element i një realiteti pa dyshim i lidhur dhe me botime që kanë të bëjnë me kontekstin tonë. Përpjekje për të gjetur ndërlidhje mes zhvillimeve në këtë drejtim rreth të dhënave që disponojmë mbi botime a ekzemplarë në vendin tonë e më tej dhe në viset që lidhen me rrethanat gjegjëse të realizimit të tyre janë shënuar në proces të studimeve që kishin objekt të vëmendjes vepra të veçanta të letërsisë së vjetër shqipe, duke qenë dhe vetë lënda e përmbajtja një shtysë konkrete për të gjurmuar të tilla elemente.

Favorizimi i përhapjes së librit të shtypur ndaj atij të realizuar me teknika të mëparshme ndikoi pa dyshim dhe në zhvillimin e një debati të iniciuar me ihtarë të reformave të fuqishme që luajtën rol në historinë e kishës së Romës dhe më tej në lindjen e prirjeve të tjera që të zhvilluara në vende më në veri si Gjermania, do të bënin të mundur që të lindnin të tjera vepra, dhe pse gjithashtu me karakter fetar të theksuar. Gjashtëqinda, shekulli në të cilin realizohen dhe doracakët e Pjetër Budit e më tej dhe vepra madhore *Cuneus prophetarum (Patavii, 1685)* e Pjetër Bogdanit do të njohë dhe zhvillime që lidhen me ngjarje që shënuan në mënyrë të pakthyeshme rrethet kishtarë të Romës e më tej, duke qenë se pikërisht në këtë periudhë do të shohin dritën e shtypit variante biblike që mbetën referenca me rëndësi për mbarë historikun e botimeve biblike në Evropë.⁵ Kësisoj, çdo realizim që pa dritën e shtypit dhe në gjuhën shqipe e që priret nga e njëjta tematikë që diktohet nga zhvillimet e sipërcituara, reflekton dhe ndikime të vetëkuptueshme në dritën e një orientimi që prekte dhe librin e kulturën e njohjes së tij dhe në viset tona.

Gjashtëqinda do të shënohet dhe nga përpjekje për ta bërë të njohur doktrinën e Bellarminos në vise të largëta në pikëpamje gjeografike dhe të njohjes së kishës së Romës. Do të mund të gjejmë dhe evidentojmë në funksion të këtij fakti variante dygjuhëshe që përveç gjuhës në të cilën Bellarmino përpiloi tekstet doktrinare e kateketike, do të përmbajnë dhe gjuhën e vendit në të cilën do të shpjegohej gjithashtu një aparat didaktik dhe i pajisur me elemente shpjegimi të mjaftueshme për të transmetuar nocione bazë të një edukimi kishtar. Që pikërisht ky i fundit dhe tekstet që mbajnë autorësinë e tij që ndikuan në zhvillime pozitive në leximin e librave themelorë për njohjes e doktrinës së krishterë në viset ku Roma ushtronte ndikimin e saj, e një fakt i tillë me gjithë ndryshimet që mund të vihen re sa në një vepër në tjetrën,

⁵ Shih në veçanti kapitullin me titull "Cuneus prophetarum", në L. Marlekaj, *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo (con la riproduzione fotografica di centotrentadue documenti)*, Liantonio editrice, Bari, 1989, f. 129-155.

konkretizohet përmes analizash dhe në letërsinë kishtare në gjuhën shqipe që u përrua në shekullin XVII.

Në vendin tonë, të tilla variante do të eksplororeshin më vonë, pikërisht në Tetëqindën e falë një misionari (Atë Zef Guagliatës S.I.) që njihte dhe kontekstin tonë, në veçanti atë të Veriut të Shqipërisë falë përvojave që i mundësonte kontakti me popullsitë e atjeshme dhe qëndrimi për njëfarë kohe për arsye të detyrës meshtarake.⁶

Letërsia kishtare e shkruar në gjuhën shqipe njih disa variante në pikëpamje doktrinash dhe një larmi e tillë dëshmon dhe përpjekjet për të lëvruar në këtë gjuhë një kulturë besimi e jetësore që pikërisht trashëgimia gjuhësore e bën të prekshme në atë kohë dhe shekuj më vonë. Prirje të ngjashme gjurmohen dhe në trevat arbëreshe, dhe pse në lidhje me doktrinën në fjalë burim referencial mund të jetë ndonjë autor tjetër, por gjithsesi me përkatësi të qartë ndaj periudhës së reformimit kishtar.⁷

Studimi në pikëpamje metodologjike i një periudhe që rreket dhe të zgjerohet në syrin e studiuesve falë një dokumentacioni që veçanërisht në vitet e fundit ka pasur një përforsim e shtjellim të dukshëm si rezultat i një qasjeje më këmbëngulëse ndaj arkivave përkatëse, përbën një argument kompleks që duhet të marrë parasysh dhe kontribute të përpiluara në kohë të ndryshme, një pjesë e të cilave dhe në një ndarje kohore që sa u takon teksteve kishtare dhe receptimit të tyre, bëri të ndeshen vështirësi më se të kuptueshme.⁸

Është tashmë fort e qartë që një panoramë që njihej nga veprat e autorëve kryesorë përfaqësues të një periudhe që ngërthente më se dy shekuj, është pasuruar me njohjen e kontributeve që përforcojnë kuadrin e mëparshëm me dëshminë e përpilimeve që qëndrojnë në të njëjtën linjë tematike e që përbëjnë dhe një rikonfirmim të përpjekjeve për të reflektuar të njëjtën kulturë kishtare dhe me vepërza që u qëndrojnë prirjeve të përmbajtura në veprat themelore të kësaj

⁶ Shih dhe E. Paci, “La Dottrina Cristiana del Bellarmino in una versione del gesuita Giuseppe Guagliata”, në *L’Albania nell’Archivio di Propaganda Fide, a cura di A.Ndreca*, Urbaniana University Press, Romë, 2017.

⁷ Shih në veçanti L. Matranga, *E mbsuame e krështerë (a cura di M. Mandalà)*, Salvatore Sciascia editore, 2004. Botimet e ribotimet e Doktrinës së përpiluar nga jezuiti G. Ledesma S.I. gjurmohen dhe pranë regesteve të tipografisë Zannetti në Romë, pranë së cilës u mundësuan dhe variantet më të para të Doktrinës së Pjetër Budit (1618). Një prej ribotimeve të Doktrinës së Ledesmas është realizuar po në Romë, gjithnjë pranë kësaj tipografie, në vitin 1593.

⁸ Mbeten për t’u shënuar e nënvizuar sprovat e shumta të ndërmarra nga studiuesi Bardhyl Demiraj në pikëpamje të evidentimit të të dhënave biografike mbi prelatë të shumtë që operuan në shekujt që pasuan Pesëqindën e mbi të cilët mund të vilen indice dhe në regjistrat përkatës të kolegjeve në viset italice, në të cilat dhe gjetën strehë e edukim në proces të formimit të tyre individual. Shih në veçanti B. Demiraj, *Areali kulturor i Veriut në shek. XV-XIX*, Onufri, Tiranë, 2017.

letërsie. Njohja e tyre lehtësohet ndjeshëm nga një metodologji më konkrete në pikëpamje të realizimit të botimeve kritike e filologjike që pikërisht dekadat e fundit është përfaqësuar përmes shkollash të ndryshme të brendësimit e të përafrimit me tekstin, duke bërë të mundur që dhe në këtë drejtim gjurmimet përkatëse të pësojnë hapa përpara në shumë pikëpamje.

Paralelisht me punën e mirëfilltë filologjike që kërkonte riprodhimi mbi baza shkencore i këtyre veprave është hulumtuar si në mundësinë e gjetjes së dokumenteve shkrimore që hedhin dritë më shumë mbi të njëjtën periudhë kohore, ashtu dhe me burime arkivore në të cilat gjinden të dhëna mbi personalitete të kulturës kombëtare që iu kushtuan lëvrimit të shkrimit dhe trashëgimisë gjuhësore shqiptare.

Nënvizimi i rëndësisë që paraqesin botimet e plota të veprave të letërsisë së vjetër shqipe lidhet drejtpërdrejt me qasjen objektive ndaj një kontekstualizimi sa më adekuat të tyre në panoramën historike që shërben dhe si paraprijëse e një historie madhore të letërsisë së shkruar shqipe, pjesë e pandashme e së cilës mbetet dhe periudha e konsiderueshme e që u karakterizua nga një prodhimtari specifike në fushë të kulturës kishtarë, me prurje letrare dhe gjuhësore mjaft të vlefshme për vetë botën shqiptare dhe kombëtarizmën. Në këto botime vilen natyrshëm dhe të dhëna biografike që vetë autorët kanë dhënë mbi veprimtarinë përkatëse jetësore, ndërkohë që ato pak indice që gjinden në pasthënien e librit të Gjon Buzukut paraqiten të pamjaftueshme dhe në kuptimin e domosdoshmërisë së referimit mbi bazën e tyre në të tjera vëllime dokumentacioni që mund të dëshmojnë më konkretisht mbi autorin, vendin e saktë ku ushtronte funksionet baritore që i ishin besuar dhe dioqezën a famullinë në të cilën operonte në mënyrë të vazhdueshme.⁹

⁹ Shih ndër të tjera dhe studimin sintetik të përpiluar nga H. Lacaj, ruajtur në Arkivin e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, në të cilin sqarohen të dhëna biografike mbi një autor si Pjetër Budi, bashkë me nënvizimin e rëndësisë që paraqet në lidhje me të njohja e kontekstit historik dhe ndërlidhja me veprimtarinë e këtij prelati të historisë sonë: Mund të themi se ndër shkrimtarët e hershëm gegë, Pjetër Budi na del si fytyra ma e mprehtë, ma energjike, pra, ma tërheqëse; shkurt ky njeri na çfaqet me një personalitet të veçantë, sepse përveç epshit të parreshtun për të shkruar e gjithnjë për të shkruar, ka edhe disa veti, që e dallojnë mirë prej shkrimtarëve të tjerë t'epokës, veti këto mjaft karakteristike për një klerik shqiptar të shekullit XVI-XVII. Nuk ka dyshim se Pjetër Budi leu rreth vjetit 1566 mbassi, kur u ba ipeshkev në vjetin 1621, ai ishte nja pesëdhjetepesë vjeç "aetatis LV annorum circiter". Masandej ai vetë pohon, në letrën e paçmueshme që me 15 shtatuer 1621 i dërgoi prej Rome Kardinal Gozzadini-t, se asht nga Guri i Bardhë (Petalba, Pietra Bianca) e se vjen prej derës së moçme "Budi" të Maqedonisë. Në lidhje me vendlindjen e këtij shkrimtari të vlershëm e shohim të arsyeshme të sjellim disa njoftime e të thana, që vlejnjë për të hedhë pak dritë mbi lashtësinë e zulmën e derës së Budejve, e cila, në pëshitetje të disa konstatimeve të vona, ka lëshue filiza deri në ditët tona.

Konsultimi ndaj indekseve të botimeve kryesisht të shekullit XVI paraqitet më i lehtësueshëm kohët e fundit, por një fakt i tillë sërish nuk shpie drejtpërdrejt në autorin a përpiluesin e *Mesharit*, duke mbetur përherë për t'u zgjidhur dhe dilema mbi lejimin e kësaj vepre për praktikën liturgjike, apo dhe mundësinë e pezullimit të saj mbas dhënies së këtij lejimi.¹⁰

Një libër i tillë i shkruar në gjuhën shqipe përbën dhe të vetmin ekzemplar që njohim dhe sot e kësaj dite në kuptimin e përmbajtjes në një vëllim të vetëm të disa modeleve që më tej, me vijimësinë e reformave kishtarë dhe përqendrimin e vëmendjes në përpilimin sa më konciz të tyre, do të mund të gjurmohen dhe në botime të mëvetësishme, duke u reflektuar së pari në traditën tonë me kontributet e Pjetër Budit dhe veprat që pasuan njëra-tjetrën në një hark të ngushtë të veprimtarisë së tij baritore. Veçantia në pikëpamje ndërtimi, por dhe në të tjera tipare që kanë të bëjnë me gërshetimin e brendisë dhe elementeve të tjera me rëndësi për të kuptuar më qartë vlerat funksionale të një ekzemplari të tillë meriton përherë një vëmendje interpretimi që në mungesë të dhënash më konkrete mbi çka ka të bëjë me këtë libër dhe historinë e tij, përbën një linjë për t'u ndjekur me rigorozitet prej studiuesve të tekstit dhe të filologjisë së shkrimeve të vjetra shqipe.

Në të vërtetë, distanca kohore që ndan të tilla realizime prej njëri-tjetrit nuk është e konsiderueshme, por veçantia e secilës prej këtyre veprave nuk përbën tjetër veç dëshmisë së kërkimit të ekzemplarëve më të mundshëm në receptimin e një kulture kishtarë dhe liturgjike sa më të përshtatshme për një vend si yni.

Të tilla përpilime që përafrojnë për nga tematika e paracaktimi, por diferencohen në të tjera tipare të ndërtimit, janë vëzhguar gjerësisht prej studiuesve të letërsisë së vjetër shqipe, duke u bërë e mundur të hulumtohet në lidhje me to pasuria gjuhësore, letrarësia e spikatur, gjithashtu dhe vlera të përdorimeve që gjinden në to. Ndërsa janë nënvizuar prej studiuesve të fushave të përcaktuara të gjurmimeve albanologjike çështje të ndërtimeve që orientojnë ndaj rindërtimit kryesisht të paradigmave e prospekteve që kanë të bëjnë më së pari me studimet diakronike mbi shqipen, edhe vlera të tjera që pikërisht në objektin tonë do të marrin një vëmendje të përveçme, janë vënë në dukje në trajtesa të caktuara shkencore.

¹⁰ Veçanërisht në Indeksën e librave të ndaluar të vitit 1596, botuar në Romë nga Selia e Shenjtë dhe sipas orientimeve të Koncilit të Trentit (1545-1563), me plotësime dhe orientime që duket se vijnë nga indekse paraprijëse në kohë, bien në sy mjaft emra të përveçëm autorësh, ndonjëherë dhe pa titullin e veprës përkatëse, për të cilën këta të fundit mund të jenë dhe përgatitës apo përshtatës. Modelet librorë që ndërmenden në një indeks të tillë, janë në pjesën më të madhe të tematikave që lidhen me liturgjinë dhe teologjinë e krishterë, si dhe me historinë e besimit të krishterë.

Konsiderimi i dimensioneve që ngërthejnë të tilla vepra e realizime bën të mundur të gërshetohen jo pak kompetenca, ndër të cilat dhe ajo e brendësimit të tekstit që mban një prioritet më se të qartë në këtë rast.

Çdonjëri prej shekujve që lidhet me letërsinë e vjetër shqipe është shënuar dhe në pikëpamje të zhvillimeve të kulturës së librit në qarqet evropiane e në veçanti në rrethet kishtarë, të përfshira drejtpërdrejt në çështje të reformimit të hallkave hierarkike e të vetë strukturave themelore përkatëse. Zhvillime të tilla cekin po aq afër dhe arealin shqiptar e më në veçanti atë të Veriut, gjithashtu viset më në kontakt me ato dalmatine. Burime që kanë të bëjnë me historinë e kishës në viset arbërore janë njëkohësisht dhe një mundësi për t'u konsideruar nëse bëhet fjalë për të vjelë dhe radhitur indice mbi autorë dhe personalitete me peshë në periudha të caktuara, në veçanti në lidhje me shekujt që u bënë pjesë e konfirmimit të një tradite shkrimore që jo vetëm do të iniciohej, por dhe do të ndiqte një rrugë të vetën në pikëpamje përvijimi dhe konsolidimi.

Meriton një vëmendje të veçantë dhe trajtimi i vendit që duhet të kenë pasur veprat e letërsisë së vjetër shqipe në një kontekst historik dhe kulturor, sidomos nëse bëhet fjalë për pikëpamje që mëtojnë të hedhin dritë mbi rrethanat e lejimit të botimit të disa prej tyre. Sa u përket vështirësive për të realizuar të tilla vepra, apo mbështetjes që duhet të kenë ofruar qerthujt kulturorë të kohës, dhe autorët vetë kanë dhënë të dhëna të mjaftueshme për të mbërritur në analiza të mëtejme nga ana e studiuesve të veprës dhe periudhës së cilës i përkasin, por një fakt i tillë nuk përjashton dhe paqartësi që rrjedhin nga interpretime që nuk marrin parasysh çka reflektohet nga vetë përmbajtja e teksteve që janë vendimtare në këto raste si udhërrëfyes për brendësimin e shumë rrethanave. Veçanërisht në rastin e veprave të letërsisë së vjetër shqipe analizimi i elementeve që burojnë nga tekstet e sipërcituara përbën një premisë konkrete për të arritur në interpretime mbi historikun e veprës dhe të kontekstit në të cilin ajo mund të jetë realizuar. Të tilla elemente bëhen objekt trajtimi dhe nga studiues të historiografisë sonë, që sigurisht dhe në lidhje me të tilla vepra e autorët e tyre ofrojnë këndvështrime me interes të veçantë studimor.

Çdo vepër paraqet specifikën e vet si në pikëpamje studimore, si në pikëpamje të kontekstit që ka qenë shtysë për realizimin e saj dhe në këtë drejtim, pikërisht për veprat e letërsisë së vjetër shqipe mund të shtrohen mendime e gjykime që duhet të burojnë para së gjithash nga njohja e periudhës, por pa lënë mënjanë as vetë brendinë dhe përmbajtjen përkatëse.

Vetë çështja e përfshirjes së librit të Gjon Buzukut në një diskutim që prirej ta lidhte me Reformën dhe Kundërreformën i kërkon si domosdoshmëri të tilla premisa. Ndikimet e reformave të kohës pasqyrohen natyrisht dhe në rrethanat që çuan në realizimin e veprave të mëvona të kësaj letërsie, por disponimi i dokumentacionit arkivor dhe pse në një vijimësi të kuptueshme gjurmimi e bën më të përafërueshme problematikën e studimit dhe kontekstualizimit të tyre. Një diskutim si i sipërcituari në lidhje me një vepër

komplekse si ajo e Gjon Buzukut përafron në interesa studiues të disa fushave, ndër të cilat dhe ajo e historisë së besimit dhe e kulturës librore si një nga lamijet më me prioritet në këtë rasë. Duke qenë një ngjarje që përveç rëndësisë së padiskutueshme në fakte e direktiva, dallon dhe për zgjatjen në kohë e në mbërritjen e përfundimeve që u nevojiteshin zhvillimeve të brendshme në kishën e Romës, Koncili i Trentit ka qenë në vijimësi referim historik dhe për studiuesit e librit të sipërcituar, duke u paraqitur dhe ky i fundit i paplotë në indice përmbajtësore të domosdoshme për të ditur më shumë rreth botimit dhe përhapjes së tij në rrethet kulturore të kohës.¹¹

Vetë argumente të tilla që lidhen drejtpërdrejt me historikun e librave dhe veprave që e përfaqësojnë një letërsi specialistike si ajo e shekujve XVI-XVII, kërkojnë domosdoshmërisht përfshirjen dhe kontributin specifik të historianit, më saktë njohësit të metodologjisë së gjurmimit të burimeve të kohës, që për nga natyra dhe paracaktimi janë të një karakteri të veçantë. Nuk mungojnë në analet e kohës dhe në korpuset më të rëndësishme dokumentare përkatëse të dhëna biografike që të rimarra dhe në kohët e fundit kanë rinëvizuar rëndësinë e vështrimit historiografik mbi periudhën që u shënuar nga realizimi i veprave të kësaj letërsie, të afërta nga tematika, të ndryshme në pikëpamje të modeleve që u ndoqën në konkretizimin e tyre dhe veçorive të tjera përmbajtësore. Në këtë kuptim, korpuset me rëndësi madhore si *Illyricum Sacrum*, vëllimi VII (Tomus septimus) i Farlatit (Venetiis, MDCCCXVII) dhe të tjera *compendiume* që të përpiluara në një vijimësi sa logjike, aq dhe kronologjike, por dhe kontribute mbi to të realizuara nga medievistët tanë dhe historianë që njihnin mirë të tilla dokumente, përbëjnë dhe sot e kësaj dite referenca të mirëfillta që ndër të tjera dëshmojnë rëndësinë e qasjes pikësëpari historiografike ndaj periudhës në fjalë dhe veprave me të cilat kjo e fundit përfaqësohet.¹²

¹¹ Tashmë është më se e qartë që viti 1555 përkon me zhvillime të rëndësishme për kishën e Romës, reflektuar dhe në problematikat e zhvillimit të Koncilit të Trentit (1545-1563), i cili në rrethana të caktuara u karakterizua dhe nga ndërprerje të punimeve të tij. Një libër që përmban qartësisht elemente që lidhen me ritin romak, por që është i shkruar në një gjuhë të ndryshme nga latinishtja mund të shihet i lidhur me të tilla zhvillime, aq më tepër me faktin që tekstet biblike që përmbante dhe më tej, pjesët e para të përmbajtjes qenë diskutuar në pikëpamje përdorimi dhe nga aktorët e Koncilit. Tekstet biblike janë përfshirë dhe në të tjera modele librore, përfshirë Ritualin romak dhe Doktrinën e Kërshtenë, që nga 1600 e më tej, u panë të dilnin nga shtypi dhe si vëllime të mëvetëshme.

¹² Shih gjithashtu E. Paci, “Historia e kishës shqiptare në një përmbledhje shënimesh të Karol Pooten-it (figura prelatësh dhe provinca të rëndësishme kishtarë)”, në *Shêjzat*, n.1-2, 2020. Në *Illyricum Sacrum*, vëllim i sipërcituar, do të gjinden shënime me rëndësi mbi Pjetër Budin dhe Frang Bardhin, por dhe prelatë të tjerë që janë pjesë e një plejade kontribuuesish në zhvillimet e kohës. Vetë dëshmitë që jepen në *Illyricum Sacrum* në lidhje me Frang Bardhin (*Franciscus Episcopus Sardensis et Sappatensis*

Ribotimet e këtyre kontributeve kanë mundësuar si rishikime të teksteve, ashtu dhe shënime të domosdoshme që sqarojnë më në fund qëndrimin e autorëve përgatitës të botimeve më të hershme dhe vlerat e pamohueshme të tyre në drejtim të një studimi më të thelluar të dokumentacionit që lidhet me jetën dhe veprën e autorëve të letërsisë së vjetër shqipe. Ndër të tjera, pikërisht në kontribute të tilla të mëhershme gjejmë mundësinë të gjurmojmë dhe variante të emërimit të veprave që e shënojnë mirëfilli letërsinë e vjetër shqipe si tituj ekzemplarë të saj. Mbetet për t'u saktësuar përherë në pikëpamje termi modeli nën të cilin u realizua libri i Gjon Buzukut, emërtuar në disa mënyra nga studiuesit e veprës, në veçanti nga rizbuluesit e saj, por dhe më tej, nga interpretues të përmbajtjes dhe teksteve që kjo e fundit ndërthet. Çështja e saktësisht të modelit mbi të cilin është përpiluar ky libër vijon të jetë e një rëndësie të madhe, duke qenë se nëpërmjet sqarimit të saj, plotësohet dhe rrethi i problematikave që janë ngritur në lidhje me të, më saktë, me historikun e tij.¹³

Në projekte të përshkrimit të vetë periudhës dhe saktësisht të profilizimit të saj, rindërtimi i historikut të ekzemplarëve që e përfaqësojnë këtë të fundit, përbën një premisë më se të domosdoshme për të kuptuar dhe brendësuar më së miri kuadrin shumëplanësh në të cilin gjeti terren një prirje e tillë e lëvrimin të kulturës librore në viset shqipfolëse, ndërkohë që qasja historiografike përbën dhe më të parën linjë ndaj së cilës studiuesit duhet të përafrohen dhe orientohen për hulumtime të mëtejme studimore. Kërkime të tilla, që në të vërtetë nuk orientohen vetëm ndaj periudhës kohore, por dhe ndaj historisë së botimeve dhe tipografive tek të cilat mund të përfshihet dhe ai i veprës së Gjon Buzukut, përbëjnë dhe një linjë të rëndësishme dhe njëkohësisht të afërt me pistën më të përshtatshme për t'u ndjekur kur bëhet fjalë për rrethana të shtypit dhe receptimin e një ekzemplari të tillë në qerthuj kulturorë e shoqërorë të asaj kohe.¹⁴

XVI), dëshmojnë dhe shkallën e njohjes së veprave të tij në atë kohë, ndër të cilat veçojmë atë të botuar në gjuhën latine mbi Gjergj Kastriotin-Skënderbeun në vitin 1635, që përkon dhe me emërimin e tij si ipeshkëv i Sardës dhe i Sapës.

¹³ Në pjesë të caktuara të përmbajtjes këtë libër mund ta përafrojmë me sakramentarët apo liturgjiarët e kohës, që dhe pse në një masë të madhe rezultojnë të përpiluar në gjuhën latine, në elemente introduktive dhe që mund të shënojnë ndarje të rëndësishme brenda veprës, përkohësisht me rubrikat që përmban *Meshari* i Gjon Buzukut. Dhe në ekzemplarë të kësaj tematike, por që janë shkruar në gjuhën italiane dhe që kanë dalë në dritë të shtypit gjatë Katërqindës apo në fillim të Pesëqindës, mund të vihen re jo pak përkime, ashtu siç mund të gjinden dhe veçanti që mund të shpjegohen me një sërë arsyes, që kanë të bëjnë me vetë specifikën e botimit në fjalë.

¹⁴ Shih në veçanti artikullin me titull “*Meshari* i Gjon Buzukut. Të dhëna të reja, skenare të reja” të studiueses Lucia Nadin në revistën *Studime filologjike*, n.1-2, 2019. Referencat e qarta të studiueses Nadin ndaj historisë së shtypshkrimit në arealin

BIBLIOGRAFI

- Bogdani, P., *Cuneus prophetarum, botim kritik përgatitur nga A. Omari, (botim i dytë i përmirësuar)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2015.
- Borgia, N., *Pericope evangelica in lingua albanese del secolo XIV (da un Manoscritto Greco della Biblioteca Ambrosiana)*, Grottaferrata, 1930.
- Brevaglieri, S., “Editoria e cultura a Roma nei primi tre decenni del Seicento (lo spazio della scienza)”, në *Rome et la science moderne entre Renaissance et lumières*, Publications de l'École française de Rome, 2009.
- Bujanda, J.M., Richter, M., *Index librorum prohibitorum (1600-1966)*, Centre d'Études de la Renaissance, Université de Sherbrooke, Librairie Droz, Genève, 2002.
- Carmassi, P., *Libri liturgici e istituzioni ecclesiastiche a Milano in età medioevale (studio sulla formazione del lezionario ambrosiano)*, Aschendorff Münster, 2001.
- Camaj, M., “Il “Messale” di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi”, *Shêjzat*, Romë, 1960.
- Cordignano, F., “Geografia ecclesiastica dell-Albania dagli ultimi decenni del secolo XVI alla metà del secolo XVII”, në *Orientalia Christiana*, v.XXXVI/4, n.99, Romë, 1934.
- Çabej, E., “Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre”, në *BUSHT*, n.2, 1959.
- Çabej, E., *Shqipja në kapërcyell-Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë, 2006.
- Demiraj, B., *Gjon Nikollë Kazazi dhe “doktrina” e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.
- Demiraj, B., *Jeta dhe trashëgimia e Gjon P. Nikollë Kazazit*, Botime Françeskane, Shkodër, 2013.
- Demiraj, B., “Enciklika “Inter Omnigenas” e Papë Benediktit XIV (2 shkurt 1744) dhe roli i Imzot Gjon P. Nikollë Kazazit në përfitim e saj”, në *Shêjzat-Pleiades*, n.1-2, 2016.
- Demiraj, B., *Areali kulturor i Veriut në shek. XV-XIX*, Botime Onufri, Tiranë, 2017.

venecian dhe njohja e drejtpërdrejtë nga ana e saj e një konteksti kompleks kulturor që shoqëroi dhe lindjen e rrethëve kulturore në zë të kohës, bëjnë më bindëse dhe hipotezat gjegjëse mbi shtypjen e mundshme të librit të Gjon Buzukut në një nga tipografitë e Venedikut, nga editorë që janë pjesë e rëndësishme e historisë së kulturës librore në këtë zonë. Për një sërë arsyesh, një qendër e tillë si Venediku, e dalluar që në fillim për faktin që u bë protagoniste e zhvillimeve më të rëndësishme në fushë të shtypshkrimit, aq më tepër me një numër të madh tipografish që ishin të specializuara dhe në botimet që lidheshin me liturgjinë dhe tekstet biblike, është ndërmundur gjatë dhe me argumente të shumta dhe në lidhje me historikun e librit të Gjon Buzukut, si një prej veprave më të rëndësishme në historinë e shkrimit shqip dhe të dokumentimit të letërsisë së vjetër shqipe.

- Genesin, M., Matzinger, J., *La pubblicazione dei primi testi in lingua albanese nel contesto dell'attività editoriale della Polyglotta, në L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide*, përgatitur nga A. Ndreca, Urbaniana University Press, Città del Vaticano, 2017.
- Infelise, M., *I padroni dei libri. Il controllo sulla stampa nella prima età moderna*, Laterza, Bari, 2014.
- Ismajli, R., *Tekste të vjetra*, Botime Dukagjini, Pejë, 2000.
- Marlekaj L., *Pietro Bogdani e l'Albania del suo tempo*, Liantonio editrice, Bari, 1989.
- Matranga, L., *E mbsuame e krështerë*, (a cura di M.Mandalà), Salvatore Sciascia editore, 2004.
- Mohrmann, Ch., *Le latin liturgique*, La Maison-Dieu, n.23, 1950.
- Mohrmann, Ch., *Études sur le latin des chrétiens*, Edizioni di Storia e letteratura, 1961.
- Mohrmann, Ch., *Études sur le latin des chrétiens, Tome III, Latin chrétien et liturgique*, Edizioni di storia e letteratura, Roma, 1965.
- Omari, A., “Disa risi në fushën e botimit të teksteve të vjetra shqipe”, në Konferenca shkencore: *Çështje të studimeve diakronike të shqipes*, ASHAK, 2009.
- Omari, A., “Kontributi i “Hyllit të Dritës” në studimet filologjike shqiptare”, në *Hylli i Dritës*, numër jubilar me rastin e 100-vjetorit, Shkodër, 2013.
- Omari, A., *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2016.
- Nadin, L., *Albania ritrovata. Recupero di presenze albanesi nella cultura e nell'arte del Cinquecento veneto, përktheu Pëllumb Xhufi*, Botime Onufri, Tiranë, 2012.
- Nadin, L., “Ancora sul Meshari di Gjon Buzuku. Nuovi dati e nuovi skenari”, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 2015.
- Paci, E., “Letërsia e vjetër shqipe në kontekstin e historisë së letërsisë shqiptare”, në *Hylli i Dritës*, n. 2, 2011.
- Paci, E., “Për një vështrim tekstologjik të Mesharit të Gjon Buzukut”, në *Hylli i Dritës*, n. 3, 2011.
- Paci, E., “Kolofoni në Mesharin e Gjon Buzukut”, në *Hylli i Dritës*, n. 1, 2012.
- Paci, E., “Pikëpamje të Zamputit mbi vendin e “Mesharit” në historinë e letërsisë së shkruar shqipe”, në *Studime filologjike*, n.3-4, 2014.
- Paci, E., “Elemente të leksikut të liturgjisë në veprat e letërsisë së vjetër shqipe-Zotynë si rast studimi”, në *Hylli i Dritës*, n.3-4, 2014.
- Paci, E., “Kontributi i Gaetano Petrottës për historinë e letërsisë së vjetër shqipe”, në *Hylli i Dritës*, n. 1-2, 2015.
- Paci, E., “La Dottrina Cristiana del Bellarmino in una versione del gesuita Giuseppe Guagliata”, në *L'Albania nell'Archivio di Propaganda Fide, a cura di A.Ndreca*, Urbaniana University Press, Romë, 2017.

- Paci, E., *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2017.
- Paci, E., “Vepra e Marin Barletit, në një kontekst të historisë së letërsisë së shkruar shqipe”, në *Hylli i Dritës*, n.2, 2018.
- Paci, E., “Historia e kishës shqiptare në një përmbledhje shënimesh të Karol Pooten-it (figura prelatësh dhe provinca të rëndësishme kishtarë)”, në *Shëjzat*, n.1-2, 2020.
- Petrota, G., *Popolo, lingua e letteratura albanese (a cura di M. Mandalà)*, Edizioni Mirror, Palermo, 2003.
- Ressuli, N., *I più antichi testi albanesi*, G. Giappichelli, Torino, 1978.
- Roques, M., *Recherches sur les anciens textes albanais*, Librairie orientaliste P.Geuthner, Paris, 1932.
- Suta, B., *Faqe të panjohura nga vepra e Pjetër Budit (1618-1622)*, Botime Onufri, Tiranë, 2016.
- Zamputi, I., “Mbi rrethanat historike të botimit të Mesharit të Gjon Buzikut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare”, në *Studime filologjike*, n.3, 1986.
- Zamputi, I., “Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe”, në *Hylli i Dritës*, n.1-2, 1995.

SUMMARY

OLD ALBANIAN LITERATURE THROUGH HISTORIOGRAPHICAL OBSERVATIONS. CONTRIBUTIONS AND STUDY PERSPECTIVES

This article will focus on the value and contributions of a literature with a genuine religious and didactic character and different perspectives on the period labeled as old Albanian literature and its special authors. Some of main the topics are: - Textual and content features of the works of this literature and the impetus for further observations on the period and its historical context; - The access to archival documentation that deals with this period and the actual realizations and publications on this particular time division; -Contributions about elements of the biography of the authors of old Albanian literature; - Historiographical observations and enrichment of the treatment of the socio-literary panorama related to the old Albanian literature.

This commentary also draws attention to the methodology of research on authors and works in the study tradition of Arbëresh areas, as an orientation perspective, the philological research on doctrinal texts in the compilations of Arbëresh scholars and the essential approach to the developments in the northern Albanian area (XVI-XVIII centuries).